MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË PER PROJEKTIN "REHABILITIMI I SPITALIT TË SHKODRËS, FAZA- III "

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Njësinë e Zbatimit të Projektit të Ministrisë së Shëndetësisë për projektin "Rehabilitimi i spitalit të Shkodrës faza-III". Me objekt ""Mbi auditimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë financiare dhe vlerësimit për projektin për periudhën nga nisja e projektit deri më datë 31.05.2012" dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr.736/6, datë 06/09/2012.
Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr.736/7, datë 06/09/2012 dërguar **Z[redacted]**, Ministër i Shëndetësisë, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtëme:

A. Msa organizative

1. PIU/MSH dhe Drejtoria e Spitalit Rajonal Shkodër, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse, të marrin masa për të filluar procedurat për të bërë aplikimet për marrjen e lejes mjedisore dhe lejes së ndërtimit, për godinën e re të spitalit, pasi këto leje nuk janë siguruar nga Huamarrësi, ndonëse në Marrëveshjen e huasë është përcaktuar se duhet të sigurohen para zbatimit të saj.

"Menjëherë"

2. PIU/MSH dhe Drejtoria e Spitalit Rajonal Shkodër, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse, të marrin masa për të filluar procedurat e aplikimit për marrjen e certifikatës të vërtetimit të pronësisë për truallin mbi të cilën është ndërtuar godina e re e spitalit në Shkodër, pasi kjo certifikatë ende nuk është siguruar.

"Menjëherë"

3. Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, të marri masa për të përcaktuar afatin për realizimin e projektit "Rehabilitimi i spitalit të Shkodrës faza-III", pasi afati i përcaktuar në marrëveshjen e huasë nuk është realizuar.

"Menjëherë"

4. Ministria e Shëndetësisë të marri masa për ngritjen e një grupi pune, i cili të evidentojë dhe të përcaktojë arsyet e ndryshimit të specifikimeve teknike të mallrave nga specifikimet e kërkuara e të ofertuara dhe specifikimeve teknike bashkëlidhur kontratave të lidhura nga Drejtoria e Spitalit Shkodër për lotin II "Blerje pajisje për lavanterinë" dhe lotin IV "Blerje furnitura mjekësore".

Gjithashtu, grupi i punës të evidentojë dhe përcaktojë përputhshmërinë e mallrave të furnizuara me ato të ofertuara, pasi rezulton se artikujt e furnizuar dhe marrë në dorëzim nuk janë sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe të ofertuara nga shoqëria e shpallur fituese, nuk janë të njëjtë në paraqitje sipas fotos së produktit në ofertën teknike, katalogut, markës prodhuese, tipit, origjinës së prodhuesit, numrit identifikues të produktit.

"Menjëherë"

5. Drejtoria e Spitalit Shkodër të marri masa për instalimin e pajisjeve të lavanterisë, sipas kushteve të kontratës me objekt "Blerje pajisje për lavanterinë", pasi pajisjet e marra në dorëzim dhe që janë gjendje në magazinë ende nuk janë instaluar dhe vendosur në punë.

"Menjëherë"

6. Drejtoria e Spitalit Shkodër të marri masa që në të ardhmen komisionet e kolaudimit të mallit të kenë në përbërje të tyre specialistë dhe ekspertë të fushave përkatëse për marrjen në dorëzim dhe kolaudimin e mallrave, për të evituar marrjen fiktive të tyre.

"Menjëherë"

7. MSH të marri masa për realizimin sa më shpejt të procedurave të prokurimit me objekt "Blerje pajisje mjekësore" dhe "Blerje pajisje për kuzhinën", për Spitalin e Shkodrës faza-III, pasi sipas Marrëveshjes së huasë komponenti "Teknologji mjekësore", është kontribut i QSH i cili realizohet nga MSH dhe duhet të ishte realizuar brenda vitit 2011.

"Menjëherë"

8. Drejtoria e Spitalit Shkodër të marri masa për ngritjen e grupit të kolaudimit dhe marrjen në dorëzim të Godinës së rikonstruktuar të ish-spitalit të Pediatrisë, e cila ka përfunduar dhe disa reparte në këtë godinë janë vënë në funksionim.

"Menjëherë"

9. Njësia e Zbatimit të Projektit të marrë masa për ndjekjen e realizimit të punimeve të pakryera, por të situacionuara dhe të likuiduara, në vlerën **23,640 euro,** për zërin "Punime për veshje dyshemeje me gomë" dhe t'i zbritet vlerës së situacionit pasardhës të punimeve të firmës kontraktore [redacted].

Menjëherë

10. MSH/PIU të marri masa që fondet e huave /kredive për financimin e projekteve në fushën e shëndetësisë, të mos përdoren për të përballuar veprimtari të cilat nuk janë të përcaktuara në marrëveshjet financiare, pasi për projektin "Rehabilitimi i spitalit Shkodër faza-III", si pasojë e punimeve të kryera për rikonstruksionin e një magazine dhe përshtatjen për ambjent banimi, të cilat nuk janë parashikuar si veprimtari të projektit, është rënduar padrejtësisht kosto e projektit në shumën 18,809 euro.

"Në vazhdimësi"

11. PIU/MSH në bashkëpunim me kompaninë konsulente dhe Drejtorinë e Spitalit Shkodër të marri masa për përshtatjen e ambienteve ku do vendoset Reparti i Dializës në godinën e spitalit të ri që po ndërtohet, në përshtatje me aparaturave ekzistuese të dializës dhe sipas kërkesave të mjekëve specialistë.

"Menjëherë"

12. Drejtoria e Spitalit Shkodër të marri masa për vënien në funksionim të katit të tretë (Reparti i Pediatrisë) të godinës së rehabilituar të spitalit ekzistues, godinë në të cilën kanë përfunduar punimet e ndërtimit.

"Menjëherë"

13. MSH të marri masa që në të ardhmen disbursimet e huave/kredive të akorduar nga donatorë të ndryshëm në sektorin e shëndetësisë, të realizohen brenda afateve të përcaktuara në marrëveshjet përkatës, pasi për projektin "Rehabilitimi i spitalit të Shkodrës, faza-III", ka patur vonesa në realizimin e disbursimeve.

"Në vazhdimësi"

14. MSH/Drejtoria Ekonomike, të marri masa që në të ardhmen pagesat e TVSH dhe kosto lokale për projektet dhe investimet me financime të huaja të kryera në sektorin e shëndetësisë të kryhen brenda afatit të përcaktuar, për arsyen se vonesat në kryerjen e këtyre pagesave shoqërohen me mosrealizim të projektit brenda afateve të përcaktuara.

"Në vazhdimësi"

15. MSH të marri masa që fondet e huave /kredive për financimin e projekteve në fushën e shëndetësisë, të mos ndryshojë strukturën e Njësisë së Zbatimit të Projekteve, pasi për projektin "Rehabilitimi i spitalit të Shkodrës, faza-III", si pasojë e ndryshimit të strukturës së PIU-t në kundërshtim me marrëveshjen e huasë është shkaktuar një efekt negativ financiar në shumën 3,657 euro.

"Në vazhdimësi"

16. Drejtoria e Spitalit Shkodër të marrin masa për të vënë në funksionim autoklavën grirëse për trajtimin e mbetjeve spitalore nga kompania furnizuese [redacted].

"Menjëherë"

17. PIU/MSH të marri masa për të inventarizuar dosjet e projektit dhe të arkivohen, në përputhje me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003, "Për arkivat".

"Menjëherë"

B. <u>MASAZHDËMTIMI</u>

1. Të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik me vlerë **4,046,400 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për drejtorin e Spitalit Shkodër [redacted] dhe Kryetarin e Degës së Shitjes në DSSH, aktualisht jurist pranë Degës së Shitblerjes [redacted] për ndryshimin tërësisht të specifikimeve teknike, përmasat dhe materialin për gjashtë artikuj të lotit IV "Blerje furnitura mjekësore".

"Menjëherë"

2. Të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik me vlerë **888,000 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për përgjegjësin material [redacted] për mungesën e disa artikujve për pajisjet e lavanterisë të marra në dorëzim.

"Menjëherë"

3. Të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik me vlerë **576,000 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për përgjegjësin material [redacted] për mungesën e disa artikujve për furniturat mjekësore të marra në dorëzim.

"Menjëherë"

C. <u>MASA ADMINISTRATIVE</u>

Mbështetur në pikën 3/ç të nenit 13 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", me ndryshimet e mëvonshme, kërkojmë të fillojnë procedurat ***për përjashtimin nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit për një periudhë 3 vjeçare*** **për operatorin ekonomik [redacted],** për arsyet si më poshtë:

Për mospërmbushje të detyrimeve kontraktuale në kontratat e lidhura nga Drejtoria Spitalore Shkodër për lotin II "Blerje pajisje për lavanterinë", me nr. 929 prot., datë 10.10.2011, me vlerë 17,556,000 lekë dhe lotin IV "Blerje furnitura mjekësore", me nr. 930 prot., datë 10.10.2011, me vlerë 26,081,040 lekë.
Pajisjet e lavanterisë të furnizuara nga kompania [redacted], për lotin II, nuk janë të prodhuara nga kompanitë prodhuese të përcaktuara në ofertën teknike të furnizuesit të shpallur fitues. Pajisjet e furnizuara nuk janë të njëjta në paraqitje sipas fotos së produktit në ofertën teknike, katallogut, markës prodhuese, tipit, origjinës së prodhuesit, numrit identifikues të produktit dhe nuk janë sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe të ofertuara nga shoqëria [redacted], e shpallur fituese, veprim i cili bie në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.
Furniturat mjekësore të furnizuara nga kompania [redacted], për lotin IV. nuk janë të prodhuara nga kompanitë prodhuese të përcaktuara në ofertën teknike të furnizuesit të shpallur fitues, pjesa më e madhe (artikujt nga nr. 4 deri nr.24), janë të prodhuara në vend, me material të cilësisë shumë të dobët dhe nuk janë të përshtatshëm për përdorim spitalor. Pjesa tjetër e artikujve, identifikohen nga markë prodhuese e ndryshme nga ajo e përcaktuar në ofertën teknike fituese. Marka e këtyre pajisjeve nuk përputhet me specifikimet teknike të ofertuara dhe të shpallura fituese nuk janë sipas katalogut, nuk ka numër indetifikimi i produktit.
Ndryshe nga sa është parashikuar në ofertën teknike të operatorit fitues dhe në kontratën e lidhur, malli është sjellë nga firma jo në materialin e kërkuar dhe të ofertuar "çelik" por me material të një cilësie më të ulet "melamin" (i cili ka çmim më të lirë).

D. <u>MASA DISIPLINORE</u>

I. Mbështetur në Urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë nr. 438, datë 01.05.2008 "Për lirimin dhe emërimin e drejtorit të Drejtorisë së Spitalit Shkodër", kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

a) "Lirim nga detyra"

1. Për [redacted], me detyrë drejtor i Spitalit Rajonal Shkodër, në cilësinë e titullarit të Autoritetit Kontraktor, për arsye se:

-Nuk është lidhur kontrata për lotin I "Pajisje kuzhine" brenda afatit të përcaktuar në VKM nr.1, datë 10.01.2007 "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar, kreu I, pika 3, gërma "ç".
-Kontrata e lidhur për lotin II "Blerje pajisje për lavanterinë", me nr. 929 prot., datë 10.10.2011, me operatorin ekonomik [redacted], me vlerë 17,556,000 lekë nuk është në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore "Për prokurimin publik", Dokumentet Standarte të Tenderit, Kushtet e përgjithshme dhe Kushtet e Vecanta të Kontratës; Aneksi i kontratës nuk ka të përcaktuar specifikimet teknike, kompaninë prodhuese, origjinën e mallit dhe numrin identifikues të produktit, veprim i cili bie në kundërshtim me nenin 1 të kontratës së lidhur; Bashkëlidhur kontratës mungojnë oferta teknike, specifikimet teknike të ofertuara nga shoqëria fituese, të cilat duhet të ishin pjesë integrale e saj.

Ka ngritur Komisionin e kolaudimit të mallrave për lotin II dhe IV, jo në përputhje me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, kreu X, pika 2 "Mbikëqyrja e kontratës", germa b) komision i cili nuk ka në përbërjen e vet specialistë të fushave përkatëse për pajisje lavanterie dhe për furnitura mjekësore.

Marja në dorëzim e pajisjeve për lavanterinë nuk është bërë në përputhje me kontratën e lidhur, neni 1 ku përcaktohet se: "...Objekt i kësaj kontrate do të jetë blerje pajisje për lavanterinë sipas sasive, cmimeve, njësive, prodhuesit dhe origjinës së mallit, që janë bashkëlidhur në aneksin nr.1 të kësaj kontrate...", pasi në procesverbalet e marjes në dorëzim nuk janë përcaktuar prodhuesit dhe origjina e mallit.

-Kontrata e lidhur për lotin IV "Blerje furnitura mjekësore", me nr. 930 prot., datë 10.10.2011, me operatorin ekonomik [redacted], me vlerë 26,081,040 lekë nuk është në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore "Për prokurimin publik", Dokumentet Standarte të Tenderit, Kushtet e përgjithshme dhe Kushtet e Veçanta të Kontratës; Specifikimet teknike, bashkëlidhur në Aneksin e kontratës nuk janë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit dhe me ofertën teknike të shpallur fituese; Janë ndryshuar specifikimet teknike të ofertuara dhe të shpallura fituese; Specifikimet e ndryshuara me Aneksin e kontratës, janë jashtë fushës së përdorimit spitalor, nuk përputhen fare me specifikimet teknike të kërkuara dhe të miratuara në Dokumentet e tenderit, nuk përputhen me specifikimet teknike që shoqëria fituese ka konkuruar në tender dhe është shpallur fituese, janë shumë më të ulta në cilësi se ato të kërkuara dhe të ofertuara, me një material shumë të dobët si dhe më të ulët në cmim, veprime të cilat kanë sjellë një dëm ekonomik **në shumën 4,046,400 lekë.**

II. Mbështetur në nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë", kontratës kolektive datë 15.12.2009 neni 8 "Lëvizjet dhe largimet nga puna" dhe kontratës individuale neni 10 "Masa disiplinore" dhe neni 11 "Masa disiplinore", kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

a) "Largim nga puna"

1. ***Për*** [redacted]*, me detyrë Kryetar Dega e Shitjes aktualisht jurist pranë Degës së Shitblerjes në Drejtorinë e Spitalit Rajonal Shkodër, në cilësinë e hartuesit të kontratave për Lotin II me objekt "Pajisje për lavanterinë" dhe Lotin IV me objekt "Blerje Furnitura mjekësore",* për arsye se:
-Nuk është lidhur kontrata për lotin I "Pajisje kuzhine" brenda afatit të përcaktuar në VKM nr.1, datë 10.01.2007 "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar, kreu I, pika 3, gërma "ç".
-Kontrata e lidhur për lotin II "Blerje pajisje për lavanterinë", me nr. 929 prot., datë 10.10.2011, me operatorin ekonomik [redacted], me vlerë 17,556,000 lekë nuk është në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore "Për prokurimin publik", Dokumentet Standarte të Tenderit, Kushtet e përgjithshme dhe Kushtet e Vecanta të Kontratës; Aneksi i kontratës nuk ka të përcaktuar specifikimet teknike, kompaninë prodhuese, origjinën e mallit dhe numrin identifikues të produktit, veprim i cili bie në kundërshtim me nenin 1 të kontratës së lidhur; Bashkëlidhur kontratës mungojnë oferta teknike, specifikimet teknike të ofertuara nga shoqëria fituese, të cilat duhet të ishin pjesë integrale e saj.

-Kontrata e lidhur për lotin IV "Blerje furnitura mjekësore", me nr. 930 prot., datë 10.10.2011, me operatorin ekonomik [redacted], me vlerë 26,081,040 lekë nuk është në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore "Për prokurimin publik", Dokumentet Standarte të Tenderit, Kushtet e përgjithshme dhe Kushtet e Veçanta të Kontratës; Specifikimet teknike, bashkëlidhur në Aneksin e kontratës nuk janë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit dhe me ofertën teknike të shpallur fituese; Janë ndryshuar specifikimet teknike të ofertuara dhe të shpallura fituese; Specifikimet e ndryshuara me Aneksin e kontratës, janë jashtë fushës së përdorimit spitalor, nuk përputhen fare me specifikimet teknike të kërkuara dhe të miratuara në Dokumentet e tenderit, nuk përputhen me specifikimet teknike që shoqëria fituese ka konkuruar në tender dhe është shpallur fituese, janë shumë më të ulta në cilësi se ato të kërkuara dhe të ofertuara, me një material shumë të dobët si dhe më të ulët në cmim, veprime të cilat kanë sjellë një dëm ekonomik **në shumën 4,046,400 lekë.**
-Kolaudimi i pajisjeve për lavanterinë nga Komisioni i kolaudimit të mallit, nuk është bërë në përputhje me kontratën e lidhur, neni 1 ku përcaktohet se "Objekt i kësaj kontrate do të jetë blerje pajisje për lavanterinë sipas sasive, cmimeve, njësive, prodhuesit dhe origjinës së mallit, që janë bashkëlidhur në aneksin nr.1 të kësaj kontrate", pasi në procesverbalet e kolaudimit nuk janë përcaktuar prodhuesit dhe origjina e mallit.

-Procesverbalet e transformimit janë hartuar në mënyrë fiktive pasi malli është sjellë nga furnizuesi në njësinë "copë" dhe është pasqyruar si i sjellë në njësinë "ml". Sipas dokumentacionit të marrjes në dorëzim dhe procesverbalet e transformimit për artikullin "tavolina" në "ml" materiali është i nëjtë, ndërsa nga kontrolli fizik rezultoi se materiali i artikullit "tavolina" është i ndryshëm në cilësi (tre lloje) veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 228, datë 29.04.2004 i ndryshuar "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare", neni 3, pika 8 dhe VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standarteve dhe rregullave kontabël, kapitulli I, pika1, 2.1 dhe 2.2.

Ka kolauduar artikujt me nr. 25 "Lavaman i salduar 370x370mm" dhe nr. 26 "Lavaman i salduar 400 x 400 mm", nr. 27 "Lavaman i salduar 600 x 400 mm" nr. 29 "Lavaman i

spitali me sistem të rritjes së presionit sipas DIN 1988 pjesa 4, me grid të palosur, 600x600x800mm, 3 panele për spërkatje", të cilët nuk janë artikuj të plotë, pasi janë furnizuar vetëm koshat e lavamanëve dhe jo bazamenti dhe aksesorët.

2. Për [redacted]*, me detyrë përgjegjës material në Degën Hoteliere në Drejtorinë e Spitalit Rajonal Shkodër,* për arsye se:
Për lotin II mungojnë tre artikuj, artikulli 6, me kod 4.2.8.7 "Lavaman për larjen e duarve", një copë artikulli 8, me kod 4.2.8.9 "Shërbimi i dozimit të detergjentëve larës", një copë dhe artikulli nr. 16 me kod 4.2.8.22 "Lavaman për larjen e duarve 600x500x750 mm", një copë gjithsej **në vlerën 888,000 lekë, vlerë e cila është dëm ekonomik,** veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 i ndryshuar "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare", neni 7 dhe 23.

Për lotin IV, mungojnë dy artikuj me nr. 15 "Dollap bazë ISO-Norm 460x660x850 1x tërheqje vertikale për ndarjen e mbeturinave (e drejtuar me pedale këmbe) kosh mbeturinash 15 litra, copë 5, dhe artikulli nr. 17, Dollap bazë 1200x560x850mm, lavaman 400x400mm, lavaman formaline 500x500 me lidhje dhe shkarkues ajri, lavaman që lidh formalinën me shkarkues ajri", copë 1 gjithsej në vlerën **576,000 lekë, vlerë e cila është dëm ekonomik,** veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 i ndryshuar "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare", neni 7 dhe 23.

Gjithashtu, mungojnë 2 frigoriferë vlera e të cilëve nuk mund te përcaktohet pasi është e përfshirë ne cmimin e artikullit me nr. 9 "Dollap i lartë DIN-Norm 660x600x2100mm, kasaforte ilacesh, frigorifer ilacesh".

b) "Vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna"

1. *Për* [redacted]*, me detyrë juriste në Zyrën Juridike të Spitalit Rajonal Shkodër, në cilësinë e anëtares së Komisionit të Kolaudimit "Për pajisjet e lavanterisë dhe furniturave mjekësore",* për arsye se:
-Kolaudimi i pajisjeve për lavanterinë nga Komisioni i kolaudimit të mallit, nuk është bërë në përputhje me kontratën e lidhur, neni 1 ku përcaktohet se "Objekt i kësaj kontrate do të jetë blerje pajisje për lavanterinë sipas sasive, cmimeve, njësive, prodhuesit dhe origjinës së mallit, që janë bashkëlidhur në aneksin nr.1 të kësaj kontrate", pasi në procesverbalet e kolaudimit nuk janë përcaktuar prodhuesit dhe origjina e mallit.

-Procesverbalet e transformimit janë hartuar në mënyrë fiktive pasi malli është sjellë nga furnizuesi në njësinë "copë" dhe është pasqyruar si i sjellë në njësinë "ml". Sipas dokumentacionit të marrjes në dorëzim dhe procesverbalet e transformimit për artikullin "tavolina" në "ml" materiali është i njëjtë, ndërsa nga kontrolli fizik rezultoi se materiali i artikullit "tavolina" është i ndryshëm në cilësi (tre lloje), veprime në kundërshtim me Ligjin nr.9228, datë 29.04.2004 i ndryshuar "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare", neni 3, pika 8 dhe VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standarteve dhe rregullave kontabël, kapitulli I, pika1, 2.1 dhe 2.2.

Ka kolauduar artikujt me nr. 25 "Lavaman i salduar 370x370mm" dhe nr. 26 "Lavaman i salduar 400 x 400 mm", nr. 27 "Lavaman i salduar 600 x 400 mm" nr. 29 "Lavaman i spitali me sistem të rritjes së presionit sipas DIN 1988 pjesa 4, me grid të palosur,

600x600x800mm, 3 panele për spërkatje", të cilët nuk janë artikuj të plotë, pasi janë furnizuar vetëm koshat e lavamanëve dhe jo bazamenti dhe aksesorët.

2. *Për [redacted], me detyrë ekonomiste Dega Hotelerie të Spitalit Rajonal Shkodër, në cilësinë e anëtares së Komisionit të Kolaudimit "Për pajisjet e lavanterisë dhe furniturave mjekësore"*, për arsye se:
-Kolaudimi i pajisjeve për lavanterinë nga Komisioni i kolaudimit të mallit, nuk është bërë në përputhje me kontratën e lidhur, neni 1 ku përcaktohet se "Objekt i kësaj kontrate do të jetë blerje pajisje për lavanterinë sipas sasive, cmimeve, njësive, prodhuesit dhe origjinës së mallit, që janë bashkëlidhur në aneksin nr.1 të kësaj kontrate", pasi në procesverbalet e kolaudimit nuk janë përcaktuar prodhuesit dhe origjina e mallit.

-Procesverbalet e transformimit janë hartuar në mënyrë fiktive pasi malli është sjellë nga furnizuesi në njësinë "copë" dhe është pasqyruar si i sjellë në njësinë "ml". Sipas dokumentacionit të marrjes në dorëzim dhe procesverbalet e transformimit për artikullin "tavolina" në "ml" materiali është i njëjtë, ndërsa nga kontrolli fizik rezultoi se materiali i artikullit "tavolina" është i ndryshëm në cilësi (tre lloje) veprime në kundërshtim me Ligjin nr.9228, datë 29.04.2004 i ndryshuar "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare", neni 3, pika 8 dhe VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standarteve dhe rregullave kontabël, kapitulli I, pika1, 2.1 dhe 2.2.

Ka kolauduar artikujt me nr. 25 "Lavaman i salduar 370x370mm" dhe nr. 26 "Lavaman i salduar 400 x 400 mm", nr. 27 "Lavaman i salduar 600 x 400 mm" nr. 29 "Lavaman i spitali me sistem të rritjes së presionit sipas DIN 1988 pjesa 4, me grid të palosur, 600x600x800mm, 3 panele për spërkatje", të cilët nuk janë artikuj të plotë, pasi janë furnizuar vetëm koshat e lavamanëve dhe jo bazamenti dhe aksesorët.

D. <u>KALLZIM PENAL</u>

Bazuar në Kodin Penal, neni 248 "Shpërdorimi i detyrës" për favorizim të padrejtë të furnizuesit shoqërisë Alen-Co sh.p.k, propozojmë të bëhet kallëzim penal pranë organeve të prokurorisë, për personat përgjegjës:

1. Z [redacted] drejtor i Spitalit Rajonal Shkodër në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, për këto arësye:

-Shkresa me nr. 2379/23, datë 3.10.2011, të Ministrit të Shëndetësisë, "Dërgim dokumentacioni për lidhje kontrate" drejtuar Spitalit Rajonal Shkodër, është e sigluar nga drejtori i DSSH dhe me shënimin drejtuar Njësisë së Prokurimit, nuk është e protokolluar në protokollin e Spitalit Shkodër, si dhe mungojnë dokumentacioni i nevojshëm për lidhjen e kontratave bashkëlidhur kësaj shkrese: Kopje të urdhërit të prokurimit, kopje të njoftimit të fituesit, kopje të sigurimit të kontratës për secilin lot dhe kopje të ofertës fituese, së bashku me dokumentacionin teknik në formë elektronike me CD, për tre lotet e përkatësisht: Loti I "Pajisje për kuzhinën", Loti II "Pajisje për lavanterinë" dhe loti IV "Furnitura mjekësore" me shoqërinë fituese [redacted].
-Kontrata për lotin IV "Blerje furnitura mjekësore", me nr. 930 prot., datë 10.10.2011, e lidhur ndërmjet Spitalit Rajonal Shkodër përfaqësuar nga drejtori [redacted] me operatorin ekonomik [redacted], me vlerë 26,081,040 lekë nuk është lidhur në

përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore "Për prokurimin publik", Dokumentet Standarte të Tenderit, Kushtet e përgjithshme dhe Kushtet e Veçanta të Kontratës; Specifikimet teknike, bashkëlidhur në Aneksin e kontratës nuk janë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit dhe me ofertën teknike të shpallur fituese, të cilat janë dërguar zyrtarisht në Dejtorinë e Spitalit Shkodër nga Ministria e Shëndetësisë me shkresën nr. 2379/23, datë 03.10.2011.

-Janë ndryshuar specifikimet teknike të ofertuara dhe të shpallura fituese në kundërshtim me dispozitat ligjore e nënligjore "Për prokurimin publik", me Kushtet e përgjithshme dhe Kushtet e Vecanta të Kontratës të përcaktuar në Rregullat për Prokurimin Publik.

Specifikimet e ndryshuara me Aneksin e kontratës, janë jashtë fushës së përdorimit spitalor, nuk përputhen fare me specifikimet teknike të kërkuara dhe të miratuara në Dokumentet e tenderit, nuk përputhen me specifikimet teknike që shoqëria fituese ka konkuruar në tender dhe është shpallur fituese, janë shumë më të ulta në cilësi se ato të kërkuara dhe të ofertuara, me një material shumë të dobët si dhe më të ulët në cmim, janë ndryshuar përmasat e artikujve si dhe materiali përbërës i tyre, i cili nga "çelik me sipërfaqe të lëmuar krom nikel" është ndryshuar në material "melamin", nuk janë përcaktuar kompanitë prodhuese, marka, numri indetifikues i produktit dhe fusha e përdorimit, ku vetëm për gjashtë artikuj, (me nr. 4, 5, 6, 7, 8 dhe 10), të cilët nuk kanë përmasat (dimensionet) dhe materialin e specifikuar, të kërkuar dhe të shpallur fituese, për të cilat ka ndryshuar plotësisht lloji i materialit përbërës nga "çelik me sipërfaqe të lëmuar krom nikel" në material "melamin", ka sjellë një dëm ekonomik **në shumën 4,046,400 lekë.**

Bashkëlidhur kontratës mungojnë oferta ekonomike dhe teknike, specifikimet teknike të ofertuara nga shoqëria fituese, të cilat duhet të ishin bashkëlidhur kontratës, pjesë integrale e saj. Aneksi i kontratës nuk ka të përcaktuar prodhuesin dhe origjinën e mallit, por ka vetëm specifikimet teknike, veprim i cili bie në kundërshtim me nenin 1 të kontratës.

Furniturat mjekësore të furnizuara nga kompania [redacted], të kolauduara nga komisioni i kolaudimit dhe të mara në dorëzim, nuk janë të prodhuara nga kompanitë prodhuese të përcaktuara në ofetën teknike të furnizuesit të shpallur fitues, pjesa më e madhe (artikujt nga nr. 4 deri nr.24), janë të prodhuara në vend, me material të cilësisë shumë të dobët dhe nuk janë të përshtatshëm për përdorim spitalor. Pjesa tjetër e artikujve, identifikohen nga markë prodhuese e ndryshme nga ajo e përcaktuar në ofertën teknike fituese. Marka e këtyre pajisjeve nuk përputhet me specifikimet teknike të ofertuara dhe të shpallura fituese nuk janë sipas katalogut, nuk ka numër indetifikimi i produktit.

Ndryshe nga sa është parashikuar në ofertën teknike të operatorit fitues dhe në kontratën e lidhur, malli është sjellë nga firma jo në materialin e kërkuar dhe të ofertuar "çelik" por me material të një cilësie më të ulet "melamin" (i cili ka çmim më të lirë), duke favorizuar në mënyrë të padrejtë shoqërinë furnizuese.

Në kushtet kur në lidhjen e kontratës janë ndryshuar specifikimet teknike të ofertuara dhe të shpallura fituese dhe specifikimet e ndryshuara bashkëlidhur kontratës janë më të ulta në cilësi por me çmim të pa ndryshuar, është e domosdoshme që të krahasohet çmimi i paguar me vlerën reale të mallit të furnizuar, pasi ka përpjesëtim të zhdrejtë midis cilësisë dhe çmimit, duke shkaktuar një dëm të konsiderueshëm ekonomik.

-Kontrata për lotin II “Blerje pajisje për lavanterinë”, me nr. 929 prot., datë 10.10.2011, lidhur ndërmjet Spitalit Rajonal Shkodër përfaqësuar nga drejtori [redacted] dhe operatorit ekonomik [redacted], me vlerë 17,556,000 lekë nuk është lidhur në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore “Për prokurimin publik”, Dokumentet Standarte të Tenderit, Kushtet e përgjithshme dhe Kushtet e Veçanta të Kontratës; Aneksi i kontratës nuk ka të përcaktuar specifikimet teknike, kompaninë prodhuese, origjinën e mallit dhe numrin identifikues të produktit, veprim i cili bie në kundërshtim me nenin 1 të kontratës së lidhur; Bashkëlidhur kontratës mungojnë oferta teknike, specifikimet teknike të ofertuara nga shoqëria fituese, të cilat duhet të ishin pjesë integrale e saj.
Në kushtet e kontratës, nuk është përcaktuar që në momentin e dorëzimit të pajisjeve të lavanterisë ato duhet të shoqërohen me manualet e instalimit, manualet e programimit, manualet e funksionimit, mirëmbajtjes dhe shërbimit të përkthyera në gjuhën shqipe, kushte këto të përcaktuara në Dokumentet e tenderit, Shtojca 7 “Kriteret e vecanta të Kualifikimit”, pika II, 7.2 “Për lotin 2”.
-Specifikimet teknike bashkëlidhur kontratës në Aneksin e kontratës, nuk janë të plota, mungojnë të dhënat e plota teknike të produkteve, nuk është përcaktuar kompania prodhuese për çdo produkt, mungon katalogu, numri identifikues i produktit, si dhe fusha e përdorimit për përdorim spitalor. Këto mungesa kanë sjellë që malli i furnizuar, kolauduar dhe marrë në dorëzim të mos jetë i njëjtë me mallin e përcaktuar në ofertën teknike të shpallur fituese.
Pajisjet e lavanterisë të furnizuara nga kompania [redacted], të kolauduara nga komisioni i kolaudimit dhe të mara në dorëzim, nuk janë të prodhuara nga kompanitë prodhuese të përcaktuara në ofetën teknike të furnizuesit të shpallur fitues. Pajisjet janë gjendje në magazinën e DSSH dhe në ambientet e spitalit të ri të pa instaluara, rifuxho dhe kryesisht të pa ambalazhuara dhe asnjë nga pajisjet e furnizuara nuk është e njëjtë në paraqitje sipas fotos së produktit në ofertën teknike, katalogut, markës prodhuese, tipit, origjinës së prodhuesit, numrit identifikues të produktit dhe nuk janë sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe të ofertuara nga shoqëria [redacted], e shpallur fituese, veprim i cili bie në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

2 z**.** [redacted], Kryetar i Degës së Shitjes aktualisht jurist pranë Degës së Shitblerjes në DSSH si hartues i kontratës për këto arësye:

-Shkresa me nr. 2379/23, datë 3.10.2011, të Ministrit të Shëndetësisë, “Dërgim dokumentacioni për lidhje kontrate” drejtuar Spitalit Rajonal Shkodër, është e sigluar nga drejtori i DSSH dhe me shënimin drejtuar Njësisë së Prokurimit, nuk është e protokolluar në protokollin e Spitalit Shkodër, si dhe mungojnë dokumentacioni i nevojshëm për lidhjen e kontratave bashkëlidhur kësaj shkrese: Kopje të urdhërit të prokurimit, kopje të njoftimit të fituesit, kopje të sigurimit të kontratës për secilin lot dhe kopje të ofertës fituese, së bashku me dokumentacionin teknik në formë elektronike me CD, për tre lotet e përkatësisht: Loti I “Pajisje për kuzhinën”, Loti II “Pajisje për lavanterinë” dhe loti IV “Furnitura mjekësore” me shoqërinë fituese [redacted].
-Kontrata për lotin IV “Blerje furnitura mjekësore”, me nr. 930 prot., datë 10.10.2011, e lidhur ndërmjet Spitalit Rajonal Shkodër përfaqësuar nga drejtori [redacted] me operatorin ekonomik [redacted], me vlerë 26,081,040 lekë nuk është lidhur në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore “Për prokurimin publik”, Dokumentet Standarte të

Tenderit, Kushtet e përgjithshme dhe Kushtet e Veçanta të Kontratës; Specifikimet teknike, bashkëlidhur në Aneksin e kontratës nuk janë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit dhe me ofertën teknike të shpallur fituese, të cilat janë dërguar zyrtarisht në Dejtorinë e Spitalit Shkodër nga Ministria e Shëndetësisë me shkresën nr. 2379/23, datë 03.10.2011.

-Janë ndryshuar specifikimet teknike të ofertuara dhe të shpallura fituese në kundërshtim me dispozitat ligjore e nënligjore "Për prokurimin publik", me Kushtet e përgjithshme dhe Kushtet e Vecanta të Kontratës të përcaktuar në Rregullat për Prokurimin Publik.

Specifikimet e ndryshuara me Aneksin e kontratës, janë jashtë fushës së përdorimit spitalor, nuk përputhen fare me specifikimet teknike të kërkuara dhe të miratuara në Dokumentet e tenderit, nuk përputhen me specifikimet teknike që shoqëria fituese ka konkuruar në tender dhe është shpallur fituese, janë shumë më të ulta në cilësi se ato të kërkuara dhe të ofertuara, me një material shumë të dobët si dhe më të ulët në çmim, janë ndryshuar përmasat e artikujve si dhe materiali përbërës i tyre, i cili nga "çelik me sipërfaqe të lëmuar krom nikel" është ndryshuar në material "melamin", nuk janë përcaktuar kompanitë prodhuese, marka, numri indetifikues i produktit dhe fusha e përdorimit, ku vetëm për gjashtë artikuj, (me nr. 4, 5, 6, 7, 8 dhe 10), të cilët nuk kanë përmasat (dimensionet) dhe materialin e specifikuar, të kërkuar dhe të shpallur fituese, për të cilat ka ndryshuar plotësisht lloji i materialit përbërës nga "çelik me sipërfaqe të lëmuar krom nikel" në material "melamin", ka sjellë një dëm ekonomik **në shumën 4,046,400 lekë.**

Bashkëlidhur kontratës mungojnë oferta ekonomike dhe teknike, specifikimet teknike të ofertuara nga shoqëria fituese, të cilat duhet të ishin bashkëlidhur kontratës, pjesë integrale e saj. Aneksi i kontratës nuk ka të përcaktuar prodhuesin dhe origjinën e mallit, por ka vetëm specifikimet teknike, veprim i cili bie në kundërshtim me nenin 1 të kontratës.

Furniturat mjekësore të furnizuara nga kompania [redacted], të kolauduara nga komisioni i kolaudimit dhe të mara në dorëzim, nuk janë të prodhuara nga kompanitë prodhuese të përcaktuara në ofetën teknike të furnizuesit të shpallur fitues, pjesa më e madhe (artikujt nga nr. 4 deri nr.24), janë të prodhuara në vend, me material të cilësisë shumë të dobët dhe nuk janë të përshtatshëm për përdorim spitalor. Pjesa tjetër e artikujve, identifikohen nga markë prodhuese e ndryshme nga ajo e përcaktuar në ofertën teknike fituese. Marka e këtyre pajisjeve nuk përputhet me specifikimet teknike të ofertuara dhe të shpallura fituese nuk janë sipas katalogut, nuk ka numër indetifikimi i produktit.

Ndryshe nga sa është parashikuar në ofertën teknike të operatorit fitues dhe në kontratën e lidhur, malli është sjellë nga firma jo në materialin e kërkuar dhe të ofertuar "çelik" por me material të një cilësie më të ulet "melamin" (i cili ka çmim më të lirë), duke favorizuar në mënyrë të padrejtë shoqërinë furnizuese.

Në kushtet kur në lidhjen e kontratës janë ndryshuar specifikimet teknike të ofertuara dhe të shpallura fituese dhe specifikimet e ndryshuara bashkëlidhur kontratës janë më të ulta në cilësi por me çmim të pa ndryshuar, është e domosdoshme që të krahasohet çmimi i paguar me vlerën reale të mallit të furnizuar, pasi ka përpjesëtim të zhdrejtë midis cilësisë dhe çmimit, duke shkaktuar një dëm të konsiderueshëm ekonomik.

-Kontrata për lotin II "Blerje pajisje për lavanterinë", me nr. 929 prot., datë 10.10.2011, lidhur ndërmjet Spitalit Rajonal Shkodër përfaqësuar nga drejtori z. [redacted] dhe operatorit ekonomik [redacted], me vlerë 17,556,000 lekë nuk është lidhur në përputhje me

dispozitat ligjore e nënligjore "Për prokurimin publik", Dokumentet Standarte të Tenderit, Kushtet e përgjithshme dhe Kushtet e Veçanta të Kontratës; Aneksi i kontratës nuk ka të përcaktuar specifikimet teknike, kompaninë prodhuese, origjinën e mallit dhe numrin identifikues të produktit, veprim i cili bie në kundërshtim me nenin 1 të kontratës së lidhur; Bashkëlidhur kontratës mungojnë oferta teknike, specifikimet teknike të ofertuara nga shoqëria fituese, të cilat duhet të ishin pjesë integrale e saj.
Në kushtet e kontratës, nuk është përcaktuar që në momentin e dorëzimit të pajisjeve të lavanterisë ato duhet të shoqërohen me manualet e instalimit, manualet e programimit, manualet e funksionimit, mirëmbajtjes dhe shërbimit të përkthyera në gjuhën shqipe, kushte këto të përcaktuara në Dokumentet e tenderit, Shtojca 7 "Kriteret e veçanta të Kualifikimit", pika II, 7.2 "Për lotin 2".
-Specifikimet teknike bashkëlidhur kontratës në Aneksin e kontratës, nuk janë të plota, mungojnë të dhënat e plota teknike të produkteve, nuk është përcaktuar kompania prodhuese për çdo produkt, mungon katalogu, numri identifikues i produktit, si dhe fusha e përdorimit për përdorim spitalor.
Këto mungesa kanë sjellë që malli i furnizuar, kolauduar dhe marrë në dorëzim të mos jetë i njëjtë me mallin e përcaktuar në ofertën teknike të shpallur fituese si dhe në procesverbalet e marrjes në dorëzim nuk janë përcaktuar prodhuesit dhe origjina e mallit.
-Pajisjet e lavanterisë të furnizuara nga kompania [redacted], të kolauduara nga komisioni i kolaudimit dhe të mara në dorëzim, nuk janë të prodhuara nga kompanitë prodhuese të përcaktuara në ofetën teknike të furnizuesit të shpallur fitues. Pajisjet janë gjendje në magazinën e DSSH dhe në ambientet e spitalit të ri të pa instaluara, rifuxho dhe kryesisht të pa ambalazhuara dhe asnjë nga pajisjet e furnizuara nuk është e njëjtë në paraqitje sipas fotos së produktit në ofertën teknike, katalogut, markës prodhuese, tipit, origjinës së prodhuesit, numrit identifikues të produktit dhe nuk janë sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe të ofertuara nga shoqëria [redacted], e shpallur fituese, veprim i cili bie në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

3. [redacted] me detyrë përgjegjës material në Degën Hoteliere në Drejtorinë e Spitalit Shkodër, për këto arsye:

Për mungesën e tre artikujve të lotit II "Pajisje lavanterie", artikulli 6, me kod 4.2.8.7 "Lavaman për larjen e duarve", një copë artikulli 8, me kod 4.2.8.9 "Shërbimi i dozimit të detergjentëve larës", një copë dhe artikulli nr. 16 me kod 4.2.8.22 "Lavaman për larjen e duarve 600x500x750 mm", një copë gjithsej **në vlerën 888,000 lekë, vlerë e cila është dëm ekonomik,** të cilat janë bërë dalje nga magazina me fletëdaljen nr.5, datë 10.04.2012 te përgjegjësi material, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 i ndryshuar "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare", neni 7 dhe 23.
Për mungesën e dy artikujve të lotit IV "Blerje furnitura mjekësore", artikulli me nr. 15 "Dollap bazë ISO-Norm 460x660x850 1x tërheqje vertikale për ndarjen e mbeturinave (e drejtuar me pedale këmbe) kosh mbeturinash 15 litra, copë 5, dhe artikulli nr. 17, Dollap bazë 1200x560x850mm, lavaman 400x400mm, lavaman formaline 500x500 me lidhje dhe shkarkues ajri, lavaman që lidh formalinën me shkarkues ajri", copë 1 gjithsej në vlerën **576,000 lekë, vlerë e cila është dëm ekonomik,** veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 i ndryshuar "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare", neni 7 dhe 23.

Gjithashtu, për mungesën e 2 frigoriferëve të lotit IV “Blerje furnitura mjekësore”, vlera e të cilëve nuk mund te përcaktohet pasi është e përfshirë ne cmimin e artikullit me nr. 9 “Dollap i lartë DIN-Norm 660x600x2100mm, kasaforte ilaçesh, frigorifer ilaçesh”.

Shënim: Auditimi i krye nga audituesit . Albana Pengili, Yllka Pulashi dhe Luljeta Shtylla më tej u shqyrtua nga k/auditues Mimoza Lloji, Drejtori i Departamentit Athanas Karaja, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Ermal Yzeiri, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm Helga Vukaj.

1.